



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 27 Prot.

Tiranë, më datë 01.03.2021

VENDIM  
Nr. 77, datë 01.03.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.03.2021:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Rikonstruksion objekti ekzistues 2 kate mbi tokë” në Zonën Arkeologjike A, Durrës me aplikues Adlei Likmeta, zhvillues Meliha Maloku dhe raportin e vëzhgimit arkeologjik nga person i licencuar ne arkeologji Ols Lafe;
  - Projekti të plotësohet me vizatimet në planimetri të funksioneve ekzistuese të objektit dhe projektin mekanik;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

KRYETAR  
Elva MARGARITI

